



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

Mbi Programin e Bursave “CHEVENING”,

Viti akademik 2021-2022

Në kuadër të Programit të Bursave “CHEVENING”, Ambasada Britanike në Tiranë njofton se Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar ofron bursa të plota për programe studimi Master në universitetet e Mbretërisë së Bashkuar, për vitin akademik 2021-2022. Këto bursa ofrohen për të gjithë ata kandidatë, të cilët aktualisht punojnë në fusha prioritare strategjike në Shqipëri dhe që, mbas përfundimit të studimeve, janë të gatshëm që njohuritë e fituara t'i zbatojnë në vendin e tyre. Bursa financohet nga shteti britanik dhe administrohet nga Ambasada Britanike në Tiranë. Ato mbulojnë shpenzimet e shkollimit, udhëtimit dhe të akomodimit.

Programet e studimit për master jepen për të ndjekur një diplomë master një vjeçare në çdo degë në çdo universitet në Mbretërinë e Bashkuar.

Aplikimet për bursat “Chevening” hapen në datën **3 Shtator 2020**

Kushtet për përfitimin e bursës, përshkrimin e detajuar të programeve studimore, si dhe informacione të tjera gjenden në adresën e mëposhtme web:

<https://www.chevening.org/scholarships/guidance/>

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE
ASISTENCËS**